

NEWSLETTER
E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIVJE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#53

Publikohet gazeta "Diaspora Shqiptare"

Diaspora Shqiptare

The screenshot shows the homepage of Diaspora Shqiptare. It features a large world map at the top left. On the right, there are several news articles with titles like "Një gazetë në kohë 'Kolere'", "Dëshirat e Shqipërisë për COVID-19", and "OSR: Raporti Diagnositik i rishqarkuar social ekonomik të COVID-19". Below the map, there's a section with small portraits and text. At the bottom, there are links for "Italia e ditëve të koronavirusit" and "Londra dhe Koronavirusi: Shëdit apo eksperiment?".

Publikohet gazeta "Diaspora Shqiptare", një projekt i financuar nga qeveria e Konfederatës së Zvicrës në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës. Një hapësirë mediatike kushtuar gjithçkaje ndodhet në Diasporën shqiptare, gazeta "Diaspora Shqiptare" ka si mision të saj informimin me profesionalizëm të komuniteteve shqiptare kudo ndodhen në botë dhe synon të jetë një hapësirë e lajmit për sfidat e migrimit, përvojën dhe realizimet e shqiptarëve larg vendlindjes. Gazeta "Diaspora shqiptare" ka bashkëpunëtorë nga Australia, në Europë, në Britaninë e Madhe, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada. Gazetën mund ta lexoni [këtu](#).

KKD / Mark Gjonaj, ndihma në Departamentin Policor në New York



Mark Gjonaj, kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së New York-ut është bërë pjesë e nismës humanitare për shpërndarjen e ushqimeve për policët e komunitetit, të cilët po janë kontributin e tyre gjatë kësaj pandemie globale që ka përfshirë tashmë dhe SHBA-në. Lajmi është bërë i ditur nga vetë Gjonaj, i cili përmes një [publikimi](#) në rrjetet sociale është shprehur: "Faleminderit burave dhe grave tona të uniformës blu. Sot, patë mundësi të vizitoja Departamentin Policor të New Yorkut të rajonit tonë dhe t'i falenderoja ata, pasi ish-oficeri i policisë së NYPD, Tony Rodriguez, pronari dhe operatori i McDonalds dhuroi ushqime për ta".

Autorët e javës nga Takimi i Shkrimtarëve të Diasporës



Denada Dreca lindi në Shkodër dhe kreu atje studimet e larta. Gazetare, përkthyesë dhe poete, ka botuar në Shqipëri disa vëllime poetike dhe libra për fëmije. Veprat e saj janë vlerësuar me tituj e çmime kombëtare dhe ndërkombëtare, janë përkthyer në disa gjuhë të huaja dhe përfshire në antologji të ndryshme letrare. Është pjesë e lidhjes së 17 akademikëve të artistëve dhe shkrimtarëve "Pergola Arte Firenze".



Jozef Radi lindi në qytetin e Elbasanit në vitin 1957, mbaroj shkollën e mesme në qytetin e Lushnjës dhe studimet për Drejtësi. Ai është autor, përkthyes i shumë veprave të njohura brenda dhe jashtë Shqipërisë. Disa prej veprave të tij janë: "Muret e Muzgut", "Kujtesa e mjegullës", "Qielli i përtejmë", "Fletorja e Vjeshtës", etj. Radi nga viti 1998 jeton midis Italisë dhe Shqipërisë

KKD / Rosario Petta, nismë humanitare në komunitet

COMUNE DI PIANA DEGLI ALBANESE EMERGENZA CORONAVIRUS

e all'imposto vi col fare ciò che è necessario:
e il rispetto di chi lo ha pensato.

San Francesco d'Assisi

QUANDO FAI LA SPESA AL SUPERMERCATO

La SpesaSospesa



Rosario Petta, kryetar i komunës "Piana Degli Albanesi" në Sicili të Italisë dhe njëherësh anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, për shkak të situatës së krijuar së fundmi nga koronavirusi, ka ndërmarrë një nismë humanitare për t'u gjendur pranë familjeve në nevojë në këto ditë të vështira. Përmes një njoftimi të publikuar në rrjetet sociale u bëhet thirrje të gjithë qytetarëve që të kontribuojnë për t'u gjendur pranë familjeve që jetojnë me dinjitet, por në kushte tejet të varfra në këto momente. Blerja e produkteve bazike ushqimore nëpër supermarketet, do të përbënte një gjest të madh bujarie për secilin dhe do ta ndryshonte situatën e këtyre familjeve, tuhet ndër të tjera në njoftim.

Njoftim për anulimin e Takimit të Juristëve në Diasporë, në datën 4 prill

The poster is titled "TAKIM I JURISTËVË NË DIASPORË" and dated "4 PRILL 2020". It features the Albanian eagle logo and the text "Aktiviteti organizohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shtetit për Diasporën".

Të nderas pjesëmarrës në Takimin e Juristëve në Diasporë, ju njoftojmë se, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, takimi i programuar për datën 4 prill shtyhet për një kohë të papercaktuar. Falenderojmë dhe u shprehim mirënjojohjen të gjithë profesionistëve të Diasporës në fushën e së drejtës, të cilët shprehën interes për pjesëmarrje në takim. Agjencia Kombëtare e Diasporës, në kuadër të misionit të saj në forcimin dhe zgjerimin e lidhjeve të bashkëpunimit me profesionistët në Diasporë, do të vijojë kontaktet me secilin prej jush. Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe urojmë shëndet për ju dhe familjet tuaja.

